



ODA  
E FARMACISTËVE  
TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



ODA  
E FARMACISTËVE  
TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 83 Dt 31.12.19

## PLANI I PUNËS

# AKTIVITET E ODËS SË FARMACISTËVE 2020

*(Prishtinë, Dhjetorë 2019)*

#### ✚ Vazhdimi i procesit të anëtarësimit, licencimit dhe rilicencimit

Duke u bazuar në të dhënat e databazës së anëtarësisë të OFK-së, planifikohet që në vitin pasues të kryejnë obligimin e anëtarësimit rreth 1250 anëtarë për vitin 2020.

Po ashtu duke u bazuar në këto të dhënat, në vitin 2020 procesit të rilicencimit do ti nënshtrohen të paktën 20 farmacistë të cilëve afati i validiteti të licencave të tyre ju skadon këtë vit.

Nga praktika e viteve paraprake presim që për her të parë të licencohen rreth 100 farmacistë.

Po ashtu në këtë vit presim të inkasojmë obligimet e të gjithë anëtarëve rreth anëtarësimit të cilët nuk kanë përmbushur paraprakisht në vitet përkatëse

#### ✚ Plotësimi i legjislacioni OFK

Gjatë zbatimit praktik nga organet e OFK-së është hasur në disa zbrastësira ligjore të cilat bashkarisht me organet përkatëse do ti plotësojmë/ndryshojmë në vitin 2020.

Bashkarisht me Këshillin Etik, Komisionin Etik do të inicohet plotësim ndryshimi i Kodit Etik për farmacistë.

Me komisioni për praktikë private profesionale do të hartojmë rregulloren për verifikimin e njohurive profesionale të fituara gjatë praktikës nga ana e farmacistit.

Gjatë këtij viti planifikohet edhe plotësim ndryshimi i akteve tjera të cilat mund të kenë probleme në zbatimin praktikë të tyre.

#### ✚ Detajizimi dhe zberthimi i kompetencave për shkollim specialistik dhe pregaditja e kuadrit ligjore nga ana e OFK-së

#### ✚ Shpërndarja e ID-Kartelave

Pas dizajnit dhe vënies në funksion të aplikacionit online për përditësimin e të dhënave të anëtarëve të OFK-së, shpërndarja e ID-Kartelave do të filloj gjatë muajit janar të vitit 2020.



- ✚ Hapësira e përkohëshme për ushtrimin e veprimtarisë së OFK-së  
Organet e OFK-së janë në diskutim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave të tyre për administratën e OFK-së, në mënyrë që shërbimet e ofruara të jenë shumë me efikasë
  
- ✚ Gurthemeli i objektit të përbashkët për Odat e Profesionistëve Shëndetësor  
Pas nënshkrimit të kontratës mes Odave të Profesionistëve Shëndetësor, dhe përkrahjes financiare nga ana e LUX Development, Komuna e Prishtinës ka premtuar se shumë shpejt përmes Kuvendit Komunal do të nxjerr vendim për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit të përbashkët të OPSH-ve. Fillimi i ndërtimit të këtij objekti pritet të ndodh në pjesën e parë të vitit 2020/
  
- ✚ Bashkpunimi me institucione tjera  
Oda e Farmacistëve të Kosovës gjatë vitit 2020 do të ketë rol kyç në monitorimin e zbatimit të udhëzimit administrativ nr 02/2019 të MSH-së për rregullimin e çmimit të produkteve dhe paisjeve medicinale përsa i përket abuzimeve me çmime të cilat janë objekt i rregullimit të këtij udhëzimi administrativ. Prandaj në vitin 2020 OFK do të nënshkruaj marrëveshje me Odën e Mjekeve të Kosovës, Odën e Infermierëve dhe institucione tjera me qëllim të efikasitetit të punë sajë.
  
- ✚ Fushata informuese në lidhje me shkeljet etike dhe masat disiplinore për këto shkelje
  
- ✚ Auditimi financiar për vitin 2019
  
- ✚ Botimi i numrit të parë të revistës farmaceutike
  
- ✚ Takime rajonale me farmacistët për diskutime të hapura mbi problemet në sektorin farmaceutik

✚ Punëtori për asgjësimin e barnave

Për shkak të ndjeshmërisë dhe rëndësisë së procesit të asgjësimit të barnave për komunitetin e farmacistëve, Këshilli Drejtues në bashkpunim me institucionet përkatëse planifikon që në vitin 2020 të organizojë punëtorin me temën “Asgjësuni i barnave”

✚ Grante për projektet ndërkomtare të farmacistëve anëtarë të OFK-së

Oda e Farmacistëve të Kosovës do të hap thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve hulumtimeve shkencore nga anëtarët e sajë në përputhje me vijën buxhetore të ndarë nga Kuvendi i OFK-së

✚ Organizimi i ditës botërore të farmacistit 25 Shtatori

✚ Organizimi i simpoziumit me temë “Diabeti”

✚ Organizimi i ëorkshopeve pa pagesë në 7 Regjionet Kryesore

✚ Organizimi i konferences Tetor

✚ Hulumtimi dhe gjetja e mekanizmave më efikase për monitorimin e e aktiviteteve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional